



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Z. Isni Kilaj u lirua në Kosovë dje me kushte të rrepta, në bazë të vendimit të Gjykatësit të Vetëm të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) të datës 3 maj 2024. Në vijim ky vendim u konfirmua edhe nga një Panel i Gjykatës së Apelit i DHSK-së më 13 maj 2024.

Në vendim, Gjykatësi i Vetëm konstatoi se ende ekziston dyshimi i bazuar se z. Kilaj ka kryer, vetë ose së bashku me të tjerë, vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Gjykatësi i Vetëm konstatoi gjithashtu se vazhdon të ekzistojë rrezik i moderuar që z. Kilaj të arratiset dhe mund të pengojë ecurinë e procedurave penale dhe të kryejë vepra penale të tjera. Ai konstatoi më tej se asnjë prej kushteve të paraqitura nga Mbrojtja e z. Kilaj dhe asnjë nga kushtet e tjera të vendosura nga Gjykatësi i Vetëm nuk mund të kufizojnë plotësisht aftësinë e z. Kilaj për të penguar ecurinë e procedurave të DHSK-së dhe për të kryer vepra penale të tjera.

Megjithatë, Gjykatësi i Vetëm arriti në përfundimin se zgjatja e paraburgimit të z. Kilaj në rrethanat aktuale do të ishte e paarsyeshme, duke marrë në konsideratë prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën e tij për liri në rrethanat e zhvillimeve të reja.

Gjykatësi i Vetëm mbajti parasysh se (i) z. Kilaj është mbajtur në paraburgim për pothuaj gjashtë muaj; (ii) për veprat penale për të cilat z. Kilaj konsiderohet i dyshuar mund të dënohesh nga një (1) deri në (5) vjet; dhe (iii) kërkesa e kohëve të fundit që Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) i paraqiti Gjykatësit të Vetëm për pezullimin e shqyrtimit të Aktakuzës së dorëzuar prej saj, për shkak se synon të paraqesë një aktakuzë të ndryshuar, vonon në mënyrë të konsiderueshme kalendarin e procesit. Për këtë arsye, Gjykatësi i Vetëm vendosi që rreziqet që do të rezultojnë prej lirimit të z. Kilaj nuk peshojnë më shumë se e drejta e tij themelore për liri.

Ndonëse është liruar, z. Kilaj vazhdon të jetë i dyshuar në proceset e DHSK-së dhe lirimi i tij është objekt i kushteve të rrepta të vendosura nga Gjykatësi i Vetëm, ndër të tjera, që ai: duhet t'i japë Administratores një garanci financiare (dorëzani) në shumën 30.000 euro; nuk duhet të largohet nga territori i Kosovës, përveçse me leje të një paneli kompetent të DHSK-së; të paraqitet çdo javë në policinë e Kosovës; nuk duhet të bëjë deklaratat publike në media dhe/ose mediat sociale lidhur me DHSK-në, ZPS-në dhe ose proceset e DHSK-së; duhet të marrë pjesë në çdo seancë gjyqësore të kërkuar nga DHSK-ja; dhe të përmbushë çdo vendim apo urdhër tjetër të Gjykatës.

Gjykatësi i Vetëm theksoi se në rast të mospërmbushjes së ndonjë prej kushteve, do të lëshohet menjëherë urdhër për arrestimin e z. Kilaj.





Për më shumë informacion, versionet e redaktuara publike të Vendimit të Gjykatësit të Vetëm të Vendimit të Gjykatës së Apelit në lidhje me lirimimin me kusht të z. Kilaj mund t'i gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, më 10 maj, Trupi Gjykes miratoi pjesërisht një kërkesë të Mbrojtjes për zgjatjen e afatit për parashtrimin e përgjigjes ndaj kërkesës së Prokurorisë për të përfshirë materiale shtesë në listën e provave materiale. Materialet në fjalë kanë të bëjnë me dëshmitarët të cilët Prokuroria synon të thërrasë për të dhënë dëshmi në qershor dhe korrik të këtij viti.

Më 14 maj, Trupi Gjykes në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* miratoi një kërkesë të Prokurorisë që një dëshmitar të japë dëshmi nëpërmjet videokonferencës, duke theksuar rreziqet për sigurinë dhe faktorë tjerë të cilët i ngriti Prokuroria. Gjykatësit ndryshuan gjithashtu datat e planifikuara për dhënie të dëshmisë nga dëshmitari për 27 dhe 28 maj.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 15 maj, në vendime më vete për secilin, Trupi Gjykes urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, duke konstatuar se për të dy të akuzuarit vazhdon të ekzistojë rreziku se do të pengojnë ecurinë e procesit ose të kryejnë vepra penale të tjera kundër atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarë që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe/ose pritet të paraqiten para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Gjykatësit konstatuan gjithashtu se komunikimet e të akuzuarve mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe vetëm me anë të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të martën, më 21 maj, duke filluar në orën 09:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore të *Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës*, më 13 dhe 14 maj, Administratorja njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake në lidhje me caktimin me kusht të Dr. Felisiti Geri, si mbrojtëse të Ismet Bahtijarit dhe të z. Tobi Kadman si mbrojtës të Haxhi Shalës, pasi mori kërkesat nga të dy mbrojtësit për ndihmë juridike sipas Rregullores për Ndihmë Juridike të DHSK-së.

## Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

